



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:242992
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06769916

P.nr.140/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Muqaj, në çështjen penale kundër të pandehurit I.V, nga Plavë, me vendbanim në fshatin, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “*Rrezikim i trafikut publik*” nga neni 370 paragrafi 8 e lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.1895/2023, të datës 14.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datën 13.01.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarit O.B, të pandehurit I.V, si dhe mbrojtësit të tij av. Ahmet Rexhaj, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 15.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 28.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I.V, i biri i M. dhe nënës Sh. e vajzërisëj, i lindur me datë në Plavë, në Mal të Zi, tani me banim në fshatin,, rr. “.....” nr....., Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i martuar, baba i ...(.) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, me kombësi Shqiptar, Shtetas i Malit të Zi, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datën 10.09.2023 rreth orës 17:35, në aksin rrugor Pejë-Prishtinë, pikërisht në fshatin Gllaviqicë K. Pejë, nga pakujdesia shkel nenin 48 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyra që, gjersa i pandehuri ishte duke lëvizur me makinën bujqësore (bursë e misrit), me të arritur në vendin e lartcekur, duke mos mbajtur shiritin e djathtë në të cilin shirit ishte duke lëvizur, me pjesën e përparme kalon në shiritin e kundërt dhe e godet automjetin e tipit (Opel Zafir) në pjesën anësore të anës së majtë i cili ishte duke qarkulluar nga drejtimi i kundërt, e si

pasojë e goditjes së pësuar automjeti Opel Zafira fillon të sillet dhe kalon në shiritin e kundërt, ku me pjesën ballore e godet automjetin e tipit Skoda Scala në pjesën anësore të goma e pasme e anës së majtë, dhe pastaj e godet edhe automjetin e tipit VW Golf në skajin e përparme të anës së majtë, ku të dy këto automjete Skoda Scala dhe VW Golf ishin duke lëvizur në drejtimin Pejë-Prishtinë, e si pasojë e aksidentit përveç dëmeve materiale lëndime të rënda trupore pëson S.B, ndërsa lëndime të lehta pësojnë O.B, B.M, A.B, K.B, SH.B, F.B, M.K, XH.B dhe vetë i pandehuri,

-Me çka ka kryer veprën penale, **“Rrezikimi i trafikut publik”** nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72 dhe nenit 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe konform dispozitave ligjore të nenit 358, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM BURGIMI**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe konform nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i **ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dymijë (2,000) euro, të cilin dënim me gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej tre (3) muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke iu llogaritur shuma prej njëzetë (20) euro për një (1) ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** **OBLIGOHET**, i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale ashtu që për ekspertizën mjeko-ligjore të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro, të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Të dëmtuarit: S.B, A.B, B.M, M.K, A.B, K.B, SH.B, F.B si dhe XH.B, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 14.02.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/II.nr.1895/2023, kundër të pandehurit I.V nga Plava, me vendbanim në fshatin,, rr. “.....” nr....., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “*Rrezikim i trafikut publik*” nga neni 370 paragrafi 8 e lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 13.01.2025, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, i dëmtuari O.B, i pandehuri I.V, si dhe mbrojtësi i tij av. Ahmet Rexhaj nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në këtë seancë, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin I.V, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi i tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Para leximit të aktakuzës, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë. Më pas gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për fajësinë apo pafajësinë.

I pandehuri I.V, i ftuar që të deklarohej për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, respektivisht për veprën penale “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit I.V, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar edhe i dëmtuari O.B, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit I.V, av. Ahmet Rexhaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i pandehuri e pranoj fajësinë pas konsultimit me mua si avokat dhe i propozoj gjykatës që ta pranojë*.

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurit, në bazë të nenin 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që i janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRK-së, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit, e datës 23.09.2023; Raporti i Aksidentit, i datës 10.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin I.V, e datës 10.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin O.B, e datës 12.09.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarin A.B, e datës 11.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin B.M, e datës 10.09.2021; Procesverbali i marrjes në pyetje të*

dëmtuarin M.K 11.09.2023; Raporti Mjekësor me nr.22248, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.222, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.22274, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.22253, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.22252, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.22251, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.22249, i datës 10.09.2023, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë; Raporti Mjekësor me nr.1528, i datës 11.09.2023, i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës; 50 fotografi të vendit të ngjarjes dhe veturave të aksidentuara; Akt ekspertimi Mjeko Ligjor, i datës 21.10.2023; Ekspertiza e Aksidentit, e datës 06.11.2023; Procesverbali për marrjen në pyetje të pandehurin në procedurë paraprake, e dt. 09.02.2024 dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par. 6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *në kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës që të marrë parasysh faktin se në faktin se në rastin konkret si rezultat i kryerjes së veprës penale përtej që janë shkaktuar lëndime të rënda për të dëmtuarën S.B kanë pësuar edhe të dëmtuarit e tjerë O.B, B.M, A.B, K.B, SH.B, F.B, M.K, XH.B dhe atë lëndime të lehta trupore, çka tregon se në rastin konkret përfshihet më shumë se një viktimë, ndonjë dënim eventual të mëparshëm të të pandehurit ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I dëmtuari O.B, ka deklaruar se: *nuk dua të parashtoj kërkesë pasurore juridike, nuk kam kontakt me të pandehurin, i njëjti nuk më ka kërkuar falje, sa i përket dënimit ia lë në vlerësim gjykatës.*

Mbrojtësi i të pandehurit I.V, av. Ahmet Rexhaj, ka deklaruar se: *e nderuara gjyqtare paraprakisht derisa isha duke u konsultuar me të mbrojturin tim lidhur me seancën e sotme i njëjti më deklaroi se lidhur me aksidentin e ditës kritike ndjehet shumë i tronditur, i mërziur dhe pa hezitim deklaroi se do të pranoj fajësinë dhe nëse me ipet mundësia nga gjykata palëve të dëmtuara do të ju kërkoj falje publikisht e për këtë për faktin se më herët nuk kam pasur rast të takohem apo të ballafaqohem me palët e dëmtuara, unë si mbrojtësi i të pandehurit të gjithë pjesëmarrësve në këtë aksident që janë palë të dëmtuara ju kërkoj falje në emër të të mbrojturit tim për faktin se siç dihet aksidentet në trafik ndodhin nga pakujdesia apo një lëshim i vogël gjatë lëvizjes me automjet mund të ketë pasoja të pa para. Sa i përket vendimit mbi dënim në këtë çështje penale me të cilën akuzohet i mbrojturi im, gjykatës i propozoj që me rastin e marrjes së dënimit ti këtë parasysh këto rrethana: pranimin e fajësisë në këtë fazë,*

kushtet dhe rrethanat te cilat ka ndodhur aksidenti, kërkim falja dhe pendimi i thellë për atë që ka ndodhur lidhur me aksidentin, faktin se edhe me aktin akuzues përshkruhet se deri te kjo veprë penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 e lidhur me par. 6 të KPRK-së tregon se aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia, gjendja jo e mirë ekonomike e të pandehurit siç shihet në shkresat e lëndës dhe deklaroi vetë, e bënë një punë shumë të rendë për ta mbajtur familjen prej shtatë anëtarësh, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar më parë, e këtë e bazoi në shkresat e lëndës që nuk ka të kaluar kriminale , dhe nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për kurrfarë veprë penale andaj të gjitha këto se bashku i propozoj gjykatës që ti marr parasysh si rrethana veçanërisht lehtësuese me rastin e marrjes se dënimit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, i përballueshëm dhe të mos i cenohet ekzistenca e tij, pasi që është mbajtës i vetëm i familjes.

I pandehuri I.V, ka deklaruar se: *pajtohem me atë që ka deklaruar mbrojtësi im, jam penduar thellë për veprën penale, unë dhe familja ime kërkoj falje publike për të gjithë të dëmtuarit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do jem i kujdesshëm.*

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do t'a zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu qe ndaj të pandehurit si rrethana lehtësuese ka marr parasysh faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale që akuzohet, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë, i ka kërkuar falje të dëmtuarve shprehimisht gjatë seancës, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, pasi që ka qenë hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe që nga ajo kohë i njëjti nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të kryerjes së ndonjë veprë penale tjetër, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërkaq si rrethana rënduese përtej elementeve të veprës penale gjykata konstatoi në këtë rast së pari numrin e lartë të dëmtuarve, ku si rezultat i kryerjes së veprës penale kanë pësuar lëndime të lehta trupore nëntë (9) persona duke përfshirë edhe vetë të pandehurin, ndërkaq e dëmtuara S. B. ka pësuar lëndime të rënda trupore, ku nga akt-ekspertiza e datës 21.10.2023, nga Dr. Naim Uka, specialist i mjekësisë ligjore janë përcaktuar edhe lloji i dëmtimeve që e njëjta ka pësuar, duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, të cilin dënim konform nenit 43 dhe 44 të KPRK-së, pas dhënies së pëlqimit nga ana e të pandehurit i'a ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën e përcaktuar si në dispozitiv.

Gjykata në bazë të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi*

me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”, me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ia zëvendësoi në dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, pëlqim të cilin e ka dhënë i pandehuri si në procesverbalin shtesë të përpiluar pas shpalljes së aktgjykimit dhe atë me datën 15.01.2025.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar me burg efektiv e pastaj i zëvendësuar në dënim me gjobë me pëlqimin e të pandehurit, ndaj të njëjtit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par. 3 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ekspertizës mjekoligjore dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ashtu që të dëmtuarit i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

I dëmtuari O.B, me vendbanim në fshatin Zahaq, Komuna e Pejës, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, respektivisht nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, andaj mbi këtë arsye gjykata, e në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 458, 459 dhe 460 të KPPRK-së, të dëmtuarin nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Andaj gjykata mbi bazën e të dhënave si me lart dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 449, 462 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.140/24, me datën 28.01.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale:
Leonita Lajqi Muqaj

Gjyqtarja e vetme gjyquese:

Numri i lëndës: 2023:242992
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06769916

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.